



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETAR I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM  
Nr. 2, Dt. 21.09.2010

*Per shfuqizim te vendimit nr 16, date 06.08.2007 te K.B.U "Vjose" dhe anullim te lejes per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Shushice, ne afersi te fshatit Lubonje, ne jug-perendim te tij, komuna Armen, subjektit "A&D" sh.p.k, Vlore, me administrator Z. Agim Shorraj.*

Ne mbeshtetje te Vendimit Nr.63, Dt. 26.01.2001,"Per procedurat e kerkimit, te shqyrtimit dhe dhenies se autorizimeve, te lejeve dhe koncensioneve, per perdorimin e rezervave ujore", pika 16 e te ciles percakton, afatet brenda te cilave subjekti ka fituar te drejten e perdorimit te nje rezerve ujore duhet te filloj veprimtarine jane ... Per lejet 12 muaj ....., pas ketij afati subjekti humbet te drejten e perdorimit te kesaj rezerve ..., si dhe pikes 2 ne kushtet e "Ndryshimit ose anullimit te lejes", sipas se ciles "Leja anulohet kur subjekti nuk paguan detyrimet financiare dhe nuk rakordon per to me Agjensine e ujit perkatese, brenda nje afati kohor tre muaj", duke qene perpara faktit qe subjekti "A & D" sh.p.k., me administrator Z. Agim Shorraj, nuk e ka konsumuar te drejten per shfrytezimin e shtratit te lumit Shushice, per nxjerrjen e materialeve inerte (zhavorr) brenda nje viti dhe nuk e ka paguar as detyrimin per lejen dhe as per siperfaqen e dhene ne shfrytezim, duke vete humbur te drejten e perdorimit te kesaj leje, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr 16, date 06.08.2007 te K.B.U "Vjose" dhe anullim te lejes per shfrytezim te materialeve inerte ne shtratin e lumit Shushice, ne afersi te fshatit Lubonje, ne jug-perendim te tij, komuna Armen, Qarku Vlore, subjektit "A&D" sh.p.k, Vlore, me administrator Z. Agim Shorraj.
2. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
3. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"

Ardian DINE

KRYETARI K.B.U "VJOSE"  
Hasan HALILI

